

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i Eleminimit të Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tiranë

A- SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Per realizimin e shërbimit per trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, bazuar ne kerkesat e legjislacionit ne fuqi, operatori ekonomik duhet te siguroje:

1- Furnizimin me bazen materiale te nevojshme per realizimin e ndarjes ne burim dhe magazinimin provizor te mbetjeve spitalore deri ne terheqjen e tyre, sipas kerkesave per secilin kod te mbetjeve spitalore.

Per kete qellim, Operatori Ekonomik duhet te vërë ne dispozicion te AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, kuti kartoni (njëpërdorimshëm) për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Kompania duhet te realizoje nje furnizim të përshtatshëm në cdo kohe me materiale ndihmese te nevojshme per grumbullimin e perkohshem te mbetjeve.

I. Materialet ndihmese duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent) “Mbrotja nga dëmtimi prej objekteve të mprehta - Kërkesat dhe metodat e testimit - Kontenierët (enët) e objekteve të mprehta”.
- Hapja të jetë aq e gjerë sa të lejojë që mbetjet spitalore të hidhen në kuti duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e mbetjes spitalore për të cilën është projektuar kutia për të mprehtat, hapja në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në kuti;
- Të jenë të tilla që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e kutive për të mprehtat të mos lejojnë rrjedhje;
- Të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);

- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të jenë me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me kapak ngjyrë të kuq ose të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. ku të lexohen qartë fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

Koshat plastikë (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent)
- Të tillë që të mbyllen në mënyrë të sigurtë;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe shpimet;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropylene);
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa perkatese sipas pikes II të këtyre Specifikimeve "ETIKETIMI".

Shënim: Në rastin e koshave plastikë shumëpërdorimësh, duhet të garantohet larja dhe dezinfektimi i tyre ne makinerinë përkatëse të specializuar

Qeset plastike

Janë qese plastike për grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve spitalore dhe mbetjet e lidhura me to, përveç mbetjeve të mprehta.

- Të jenë me trashësi jo më të vogël se 70 mikron dhe të kenë rezistencë të mjaftueshme për të mbajtur në mënyrë të sigurt klasën e mbetjeve për të cilat ato janë caktuar;
- Të kenë kapacitet maksimal nominal prej 0.1 m³;
- Të jenë të përmasave dhe formës së përshtatshme për enët mbajtëse me të cilat do të përdoren;
- Të jenë të pajisur me lidhëse për mbyllje të sigurt. Të mos mbyllen me kapse ose me pajisje të tjera mbyllëse me dalje të mprehtë.
- Të jenë të tilla që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet ose që të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa përkatëse

II. ETIKETIMI

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila të përmbajë shenjë ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuara në më poshtë: Etiketa të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitëse, ose të jetë e stampuar një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

PËRMASAT E SIMBOLIT

Tipi i kontenierit të mbetjeve spitalore

Përmasat e simbolit

Për të mprehtat:

- i. me kapacitet prej më pak se 2 litra
- ii. me kapacitet prej 2 litra ose më shumë
- iii. të tjerë:

- jo më pak se 40 mm x 40 mm
- jo më pak se 75 mm x 75 mm
- jo më pak se 150 mm x 150 mm

SIMBOLI NË

Ngjyrat e simbolit të

Konturet – ngjyrë e

Fusha – ngjyrë e
enës

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë

Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – ngjyrë e zezë



ETIKETË

jenë si më poshtë:

zezë

bardhë ose ngjyra parësore e

PËRMBAJTJA E ETIKETËS

Çdo kontenier i mbetjeve spitalore, pasi mbyllet dhe vulozet, të identifikohet me një etiketë që të vendoset në pjesën e përparme të kontenierit dhe që të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- i. Identifikimin: Mbetje Spitalore
- ii. përcaktimin: “Infektuese”
- iii. fjalën sinjalizuese: Rrezik
- iv. njoftimin e rrezikshmërisë: “Mund të shkaktojë infeksion”
- v. Kodin sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve: 18.
- vi. Gjendjen: e ngurtë ose të lëngët;
- vii. Datën e fillimit dhe përfundimit të grumbullimit;
- viii. Sasinë në kg ose litra;
- ix. Prodhuesin / Kodin Unik / Adresën / Personin përgjegjës (Emër/mbiemër/firmë / nr.telefoni.

PER ORIENTIM-MODEL ETIKETE:

MBETJE SPITALORE	Infektuese
RREZIK! Mund të shkaktojë infeksion	
RRYMA E MBETJEVE: 18. (sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve)	
GJENDJA: NGURTE ☐ LËNGSHME ☐	
GRUMBULLIMI I MBETJEVE:	
DATA E FILLIMIT: ... / ... / 20 ...	
DATA E PËRFUNDIMIT: ... / ... / 20 ...	
SASIA: (.....) (kg ose l)	
PRODHUESI:	
KODI UNIK:	
ADRESA:	
PERSONI PËRGJEGJËS: (emër/mbiemër/firmë)	
Nr. Telefoni:	

Etiketat për vendin e magazinimit të AK

Kontraktori duhet të sigurojë për AK etiketat që duhet të vendosen dukshëm si shenja e rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, sipas modelit të mëposhtëm:



III. Terheqja e mbetjeve nga vendgrumbullimi dhe transportin deri ne vend trajtim.

Operatori ekonomik duhet te siguroje grumbullimin e konteniereve me mbetje ne pikat e perkohshme te magazinimit te autoriteteve shendetesore si dhe transportin e tyre ne impiantin e trajtimit me mjetet e posacme te transportit.

Njekohesisht me grumbullimin e konteniereve duhet te vihen ne dispozicion konteniere te rinj te gatshem per tu perdorur.

Mjeti i transportit, qe sherben per dergimin e konteniereve te rinj bosh, nuk duhet te jete i njejte me ate qe perdoret per grumbullimin e konteniereve te mbushur me mbetje, pra kontenieret me mbetje dhe kontenieret e rinj bosh nuk mund te transportohen me te njejten mjet transporti. Transporti i konteniereve duhet te kryhet ne menyre qe te sigurohet integriteti dhe pastertia e tyre, ne perputhje me rregullat e higjenes dhe sigurise.

Automjetet e perdorura per transportin e mbetjeve spitalore duhet te kenë karakteristikat e mëposhtme:

Çdo automjet që transporton mbetje spitalore të rrezikshme:

1. Duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me simbolin dallues ndërkombëtar të rrezikut të mbetjes spitalore që transportohet. Simboli të mos jetë më i vogël se 250 mm X 250 mm.
2. Duhet të ketë një panel paralajmërues, të vendosur dukshëm në anën e përparme dhe të pasme të automjetit për të treguar transportin e mbetjeve spitalore. Paneli paralajmërues i rrezikut (Varianti A ose B më poshtë) të jetë në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të transportit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk

mbulon asnjë dritë, targën ose shënime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht. Të dy variantet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion.

Specifikimet:

- **Materiali:** pjatë alumini (1-2 mm e trashë)
- **Veshja:** sfond reflektues
- **Ngjyrat:** konturi – i zi
sfondi – i verdhë
fjalët – të zeza
- **Përmasat:** fjalët ≥ 40 mm në lartësi
- **pjata (Versioni A):** gjatësia ≥ 200 mm; gjerësia ≥ 750 mm
- **pjata (Versioni B):** gjatësia ≥ 340 mm; gjerësia ≥ 500 mm

Varianti A

CAUTION! CLINICAL WASTE
KUJDES! MBETJE SPITALORE

Varianti B

CAUTION!
CLINICAL WASTE

KUJDES!
MBETJE SPITALORE

3. Të sigurojë kontakt minimal të njeriut me kontenierët e mbetjeve spitalore gjatë ngarkim-shkarkimit të tyre.
4. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit.
5. Të ketë një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit.
6. Të mbahet i kyçur përveç kur ngarkohet dhe shkarkohet.
7. Të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngta

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të realizojë ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit. Personeli i trajnuar dhe caktuar për këto qëllime duhet të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maskat.

IV. Dezinfektimin

Operatori Ekonomik duhet të realizojë densifikimin:

- Të kontenierëve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore duhet të dezinfektohen para dhe pas çdo terheqje.
- Mjediseve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të caktuara nga AK ku realizohet terheqja e kontenierëve, të cilët duhet të dezinfektohen në intervale të rregullta.

V. Trajtimin e mbetjeve spitalore dhe asgjесimin final te produktete te trajtimit, sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi.

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë III 2 B, Leje të Mjedisit të tipit Adhe/ose B sipas kategorise se mbetjeve dhe Akt-Miratim Higjiено-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- i. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ii. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- iii. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore:

a. Teknologjitë termike pa djegie

- i. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehtësisë së mbetjeve nga avulli nën presion.
- ii. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- iii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehtuar mbeturinat, ndërkohë mbetjet coptohen në kokrriza të thata.
- iv. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehten nëpërmjet përçimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

b. Teknologjitë kimike

- i. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.

c. Teknologjitë me djegie

- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezultojnë në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”

C. Asgjësimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjësim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjësimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër

do të jete përgjegjës që të mundësojë që ky shërbim të vazhdojë sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- a) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- b) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- c) nëse nuk ka impiante sipas germës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktoshin landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe të dokumentojë procesin.

Autoriteti Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjister minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- b. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- d. Datën e dorëzimit;

e. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;
Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajtuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Ky shërbim do të kryhet sipas specifikimeve teknike të parashikuara në DST një herë në dy ditë.

Afatet e ekzekutimit: Per realizimin e shërbimit per trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, bazuar ne kerkesat e legjislacionit ne fuqi, operatori ekonomik duhet te siguroje:

Furnizimin me bazen materiale te nevojshme per realizimin e ndarjes ne burim dhe magazinimin provizor te mbetjeve spitalore deri ne terheqjen e tyre, sipas kerkesave per secilin kod te mbetjeve spitalore.

Per kete qellim, Operatori Ekonomik duhet te vërë ne dispozicion te AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, kuti kartoni (njëpërdorimshem) për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Boterore e Shendetesise.

Kompania duhet te realizoje nje furnizim të përshtatshëm në cdo kohe me materiale ndihmese te nevojshme per grumbullimin e perkohshem te mbetjeve.

I. Materialet ndihmese duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

Per realizimin e sherbimit per trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore, bazuar ne kerkesat e legjislacionit ne fuqi, operatori ekonomik duhet te siguroje:

Furnizimin me bazen materiale te nevojshme per realizimin e ndarjes ne burim dhe magazinimin provizor te mbetjeve spitalore deri ne terheqjen e tyre, sipas kerkesave per secilin kod te mbetjeve spitalore.

Per kete qellim, Operatori Ekonomik duhet te vërë ne dispozicion te AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, kuti kartoni (njëpërdorimshem) për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Boterore e Shendetesise.

Kompania duhet te realizoje nje furnizim të përshtatshëm në cdo kohe me materiale ndihmese te nevojshme per grumbullimin e perkohshem te mbetjeve.

Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent) “Mbrojtja nga dëmtimi prej objekteve të mprehta - Kërkesat dhe metodat e testimit - Kontenierët (enët) e objekteve të mprehta”.
- Hapja të jetë aq e gjerë sa të lejojë që mbetjet spitalore të hidhen në kuti duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e mbetjes spitalore për të cilën është projektuar , kutia për të mprehtat, hapja në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në kuti;
- Të jenë të tilla që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e kutive për të mprehtat të mos lejojnë rrjedhje.
- Të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;

- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të jenë me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me kapak ngjyrë të kuq ose të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. ku të lexohen qartë fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

Koshat plastike (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent)
- Të tillë që të mbyllen në mënyrë të sigurtë;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe shpimet;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa perkatese sipas pikes II të këtyre Specifikimeve "ETIKETIMI".

Shënim: Në rastin e koshave plastike shumëpërdorimësh, duhet të garantohet larja dhe dezinfektimi i tyre ne makinerinë përkatëse të specializuar

Qeset plastike

Janë qese plastike për grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve spitalore dhe mbetjet e lidhura me to, përveç mbetjeve të mprehta.

- Të jenë me trashësi jo më të vogël se 70 mikron dhe të kenë rezistencë të mjaftueshme për të mbajtur në mënyrë të sigurt klasën e mbetjeve për të cilat ato janë caktuar;
- Të kenë kapacitet maksimal nominal prej 0.1 m³;
- Të jenë të përmasave dhe formës së përshtatshme për enët mbajtëse me të cilat do të përdoren;
- Të jenë të pajisur me lidhëse për mbyllje të sigurt. Të mos mbyllen me kapse ose me pajisje të tjera mbyllëse me dalje të mprehtë.

- Të jenë të tilla që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet ose që të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa përkatëse.

II. ETIKETIMI

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila të përmbajë shenjën ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuara në më poshtë:

Etiketa të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitëse, ose të jetë e stampuar një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

PËRMASAT E SIMBOLIT

Tipi i kontenierit të mbetjeve spitalore

Përmasat e simbolit

Për të mprehtat:

iv. me kapacitet prej më pak se 2 litra	jo më pak se 40 mm x 40 mm
v. me kapacitet prej 2 litra ose më shumë	jo më pak se 75 mm x 75 mm
vi. të tjerë:	jo më pak se 150 mm x 150 mm



SIMBOLI NË ETIKETË

Ngjyrat e simbolit të jenë si më poshtë:

Konturet – ngjyrë e zezë

Fusha – ngjyrë e bardhë ose ngjyra parësore e enës

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë

PËRMBAJTJA E ETIKETËS

Çdo kontenier i mbetjeve spitalore, pasi mbyllet dhe vuloset, të identifikohet me një etiketë që të vendoset në pjesën e përparme të kontenierit dhe që të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- x. Identifikimin: Mbetje Spitalore
- xi. përcaktimin: “Infektuese”
- xii. fjalën sinjalizuese: Rrezik
- xiii. njoftimin e rrezikshmërisë: “Mund të shkaktojë infeksion”
- xiv. Kodin sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve: 18.
- xv. Gjendjen: e ngurtë ose të lëngët;
- xvi. Datën e fillimit dhe përfundimit të grumbullimit;
- xvii. Sasinë në kg ose litra;
- xviii. Prodhuesin / Kodin Unik / Adresën / Personin përgjegjës (Emër/mbiemër/firmë / nr.telefoni

PER ORIENTIM-MODEL ETIKETE:

MBETJE SPITALORE RREZIK! Mund të shkaktojë infeksion RRYMA E MBETJEVE: 18. (sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve) GJENDJA: NGURTE ☐ LËNGSHME ☐ GRUMBULLIMI I MBETJEVE: DATA E FILLIMIT: ... / ... / 20 ... DATA E PËRFUNDIMIT: ... / ... / 20 ... SASIA: (.....) (kg ose l) PRODHUESI: KODI UNIK: ADRESA: PERSONI PËRGJEGJËS: (emër/mbiemër/firmë) Nr. Telefoni:	
---	--

Etiketat për vendin e magazinimit të AK

Kontraktori duhet të sigurojë për AK etiketat që duhet të vendosen dukshëm si shenja e rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, sipas modelit të mëposhtëm:

KUJDES! MBETJE SPITALORE



Specifikimet

- | | | |
|---------------|---|---|
| 1. Materiali: | I durueshëm, rezistent ndaj faktorëve atmosferikë, i padeformueshëm kur vendoset në pozicionin vertikal | |
| 2. Ngjyrat: | Sfondi
Shenja e Biohazardit
Germat | i verdhë
e zezë
të zeza |
| 3. Përmasat: | Pllaka

Shenja e biohazardit
Germat | lartësia $\geq$ 500 mm
gjatësia $\geq$ 600 mm
lartësia $\geq$ 150 mm
lartësia $\geq$ 40 mm |

III. Terheqja e mbetjeve nga vendgrumbullimi dhe transportin deri ne vend trajtim.

Operatori ekonomik duhet te siguroje grumbullimin e konteniereve me mbetje ne pikat e perkohshme te magazinimit te autoriteteve shendetesore si dhe transportin e tyre ne impiantin e trajtimit me mjetet e posacme te transportit.

Njekohesisht me grumbullimin e konteniereve duhet te vihen ne dispozicion konteniere te rinj te gatshem per tu perdorur.

Transporti i konteniereve duhet te kryhet ne menyre qe te sigurohet integriteti dhe pastertia e tyre, ne perputhje me rregullat e higjenes dhe sigurise.

Automjetet e perdorura per transportin e mbetjeve spitalore duhet te kenë karakteristikat e mëposhtme:

Çdo automjet që transporton mbetje spitalore të rrezikshme:

8. Duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me simbolin dallues ndërkombëtar të rrezikut të mbetjes spitalore që transportohet. Simboli të mos jetë më i vogël se 250 mm X 250 mm.
9. Duhet të ketë një panel paralajmërues, të vendosur dukshëm në anën e përparme dhe të pasme të automjetit për të treguar transportin e mbetjeve spitalore. Paneli paralajmërues i rrezikut (Varianti A ose B më poshtë) të jetë në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të transportit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk mbulon asnjë dritë,

targën ose shënime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht. Të dy variantet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion.

Specifikimet:

- **Materiali:** pjatë alumini (1-2 mm e trashë)
- **Veshja:** sfond reflektues
- **Ngjyrat:** konturi – i zi
sfondi – i verdhë
fjalët – të zeza
- **Përmasat:** fjalët ≥ 40 mm në lartësi
- **pjata (Versioni A):** gjatësia ≥ 200 mm; gjerësia ≥ 750 mm
- **pjata (Versioni B):** gjatësia ≥ 340 mm; gjerësia ≥ 500 mm

Varianti A



Varianti B



10. Të sigurojë kontakt minimal të njeriut me kontenierët e mbetjeve spitalore gjatë ngarkim-shkarkimit të tyre.
11. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit.
12. Të ketë një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit.
13. Të mbahet i kyçur përveç kur ngarkohet dhe shkarkohet.
14. Të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngta

15. Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet te realizoje ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit. Personeli i trajnuar dhe caktuar per kete qellim duhet të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maskat.

IV. Dezinfektimin

Operatori Ekonomik duhet te realizoj densifektimin:

- Të kontenierëve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore duhet të dezinfektohen para dhe pas çdo terheqje.
- Mjediseve për magazinimin e përkohshëm te mbetjeve te caktuara nga AK ku realizohet terheqja e konteniereve, te cilet duhet të dezinfektohen në intervale të rregullta.

V. Trajtimin e mbetjeve spitalore dhe asgjesimin final te produktete te trajtimit, sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë III 2 B, Leje të Mjedisit të tipit A dhe/ose B sipas kategorise se mbetjeve dhe Akt-Miratim Higjieno-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- iv. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- v. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- vi. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky

proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore

d. Teknologjitë termike pa djegie

- v. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehjes së mbetjeve nga avulli nën presion.
- vi. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- vii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet coptohen në kokrriza të thata.
- viii. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përcimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

e. Teknologjitë kimike

- ii. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.

f. Teknologjitë me djegie

- ii. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezulton në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.

C. Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjistër të posacëm, minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. numrin e identifikimit të ciklit të trajtimit;
- b. sasinë ditore, llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. datën, orën e fillimit dhe mbarimit të ciklit të trajtimit;
- d. temperaturën dhe presionin;
- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorëzon për asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të asgjësuesit të këtyre tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara;
- f. Të dhënat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, të licencës III.2.B (vlefshmërisë së tyre) dhe Kodin Unik të asgjësuesit të tepricave të mbetjeve spitalore;

D. Asgjësimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjësim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Procesi i asgjësimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do të jete përgjegjës që të mundësojë që ky shërbim të vazhdojë sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- d) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- e) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- f) nëse nuk ka impiante sipas gurmës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktojë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoriteti Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistër minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- f. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- g. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- h. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- i. Datën e dorëzimit;
- j. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajtuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

Vendi i kryrjes së shërbimit SUOGJ ”Koço Gliozheni”